



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "AbdiToptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 1176/ 5 Prot.

Tiranë, më 17.12. 2018

V E N D I M

Nr. 205, Datë 17.12.2018

PËR
AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË TË USHTRUAR
NË BASHKINË ELBASAN

Për periudhën prej 01.01.2016 deri më 30.09.2018

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të “Auditimit të përputhshmërisë”, në Bashkinë Elbasan, sipas programit të auditimit nr. 1176/1 prot., datë 22.10.2018, për periudhën prej 01.01.2016 deri më 30.09.2018.
- II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESIT

Opinion i kualifikuar

KLSH ka kryer auditimin e përputhshmërisë së aktivitetit të njësisë vendore Bashkia Elbasan dhe në përfundim të tij, grupi i auditimit mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, jep opinion lidhur me shkallën e ndjekjes nga subjekti të rregullave, ligjeve dhe kuadrit rregullator në tërësi. Nga auditimi i kryer, bazuar në evidencat e mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme, si dhe bazuar në

gjykimin dhe skepticizmin profesional, pavarësisht përpjekjeve pozitive të bëra nga Drejtuesit e Institucionit, në disa raste, veçanërisht në probleme të trashëguara nga ish komunat, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar¹. Ne besojmë se evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kualifikuar. Dhënien e opinionit të kualifikuar e mbështesim në konkluzionet e mëposhtme të arritura në përfundim të procesit të auditimit:

Baza për opinion të kualifikuar

- Për periudhën 2016-2018 janë jashtë skemës së pagesës për taksën e ndërtesës, tarifë pastrimi, tarifë ndriçimi dhe tarifë gjelbërimi, 18,000 familje të lagjeve të qytetit Elbasan, për të cilët nuk janë faturuar dhe arkëtuar detyrime sipas akt-marrëveshjes, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë për vlerën 43,200,000 lekë.

- Nuk janë ndjekur procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, e si rezultat janë krijuar 2,363 subjekte debitor për subjektet private në vlerën totale 130,323,333 lekë, 10596 familje debitorë për vlerën e detyrimit prej 75,657,000 lekësi vijon: për taksë toke në vlerën 46,160,528 lekë, për taksë ndërtesë në vlerën 16,270,955 lekë, për taksë trualli në vlerën 1,887,551 lekë, tarifa shërbimi në vlerën 11,338,924 lekë.

Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në datën 31.12.2017, janë gjithsej 10596 familje debitorë për vlerën e detyrimit prej 75,657,958 lekë për taksë toke në vlerën 46,160,528 lekë, për taksë ndërtesë në vlerën 16,270,955 lekë, për taksë trualli në vlerën 1,887,551 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 11,338,924 lekë.

Mos marrja e masave për arkëtimin e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kreu XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, neni 88-104.

- Në hartimin e buxhetit vjetor në zërin e shpenzimeve, nuk janë planifikuar detyrimet e prapambetura dhe detyrimet për faturat e pa likuiduara. Në total treguesit e buxhetit për këtë zë treguesit e buxhetit kanë diferenca midis planifikimi dhe realizimit: për vitin 2016, 2017 dhe 2018 janë realizuar respektivisht në masën 82,7% , 81,7% dhe 82,1%. Njësia vendore ka një gjendje të faturave të pa likuiduara ndaj të tretëve më datën 30.09.2018 në vlerën 176,106,951 lekë, e cila përfshin detyrime koherente dhe të periudhave të mëparshme, efekt që do të rëndojë buxhetin e ardhshëm të njësisë vendore.

-Pasqyrat financiare në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, paraqesin pasaktësi, pasi vlera prej 66,545,449 lekë ju përket investimeve të përfunduara, por nga keq kontabilizimi nuk është bërë pjesë e këtyre investimeve.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Elbasan nuk ka ngritur një sistem të plotë të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, sepse nuk është hartuar regjistri i rriskut, gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës nga të gjitha drejtoritë. Institucioni nuk ka hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve, rregulla për shpeshësinë e raportimit të menaxherëve kryesor të titullari, llojet e raporteve për informim. Drejtoria e burimeve njerëzore nuk ka kryer trajnime për ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Ka mangësi nga stafi në njohjen e kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe manualit për zbatimin e këtij ligji. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e

¹Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në çfarë mase subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara, apo kushtet e përcaktuara, si kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshje financimi etj.

Kur gabimet janë material por jo të përhapura, audituesi paraqet një opinion të kualifikuar

ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 8, pika 8, germa (ç), nenet 9, 10, 11, 16, 18/1, 20 -24, (Më hollësisht trajtuar në pikën A.1, faqe 10-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Bashkia Elbasan të marrë masa për hartimin e regjistrit të rriskut, gjurmës së auditimit, listës së proceseve të punës për secilën drejtori. Nga titullari/nëpunësi autorizues të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, sidomos për ato aktive që kanë rrisht lartë humbje apo vjedhje (automjete etj.). Të hartohen rregulla për frekuencën e raportimit të menaxherëve kryesorë tek titullari, si dhe llojet e raporteve. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për hartimin e programeve dhe kryerjen në mënyrë periodike të trajnimit të stafit lidhur me fushën dhe detyrën funksionale të secilit punonjës si dhe për njohjen e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe manualin në zbatim të tij.

Brenda muajit shkurt 2019

2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Elbasan, për periudhën 2016-2018, për arsye të ndryshme, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës 81 punonjës, (të nivelit specialist e lartë), por nga auditimi u konstatua se asnjë nga këta punonjës, përpara largimit nuk ka bërë dorëzimin e detyrës me procesverbal: dorëzimin e dosjeve shkresore, elektronike, pra të gjithë punës së krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion. Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen dhe transmetimin informacionit dhe bazës së të dhënave të krijuara në institucion, por ndërprerje të saj dhe rrjedhimisht ndikojnë në performancën e institucionit. Punonjësit e rinj të marrë rishtas në punë, përballen me vështirësinë e mungesës së informacionit të duhur, duke mos e njohur si duhet situatën e periudhës së paraardhësve të tyre. Në këtë mënyrë nuk krijohet një vazhdimësi kronologjike e transmetimit të punës së kryer nga një punonjës te tjetri, por ndërprerje e saj, në varësi të shpeshtësisë së ndërrimit të stafit, e cila sjellë edhe pasoja reale në punën e sektorëve përkatës të njësisë vendore. Në institucion nuk ka rregulla të shkruara për veprimet e punonjësve përpara largimit dhe detyrat e strukturave përkatëse të financës dhe burimeve njerëzore në raste të tilla. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 13

-VKM nr. 360, datë 14.07.2000 "Për lirin nga shërbimi civil", pikat 19, 20 dhe 21 "Dorëzimi i detyrës",

-VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", pika 50

-Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 25 -Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit (Më hollësisht trajtuar në pikën A.1. faqe 10-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Në mënyrë që të parandalohen rastet e mos dorëzimit të detyrës nga punonjësi kur ai ndërpret marrëdhëniet e punës, nga titullari të vendosen rregulla të brendshme të shkruara për këtë qëllim: të hartohet urdhër i veçantë apo të shtohet në rregulloren e brendshme dhe për këtë të njihen të gjithë punonjësit. Në këto rregulla të përcaktohet detyrimi që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet "pronë e institucionit". Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i financës, burimeve njerëzore etj.

Brenda muajit janar 2019

3. Gjetje nga auditimi: Në verifikimin e listave të subjekteve debitorë në vite, konstatohen subjekte aktive, por me detyrime. Kështu sipas të dhënave rezultojnë 2087 debitorë aktiv me vlerë 125,629 mijë lekë, e barabartë kjo me 88.3 % të numrit total të subjekteve 2363, dhe 98% e vlerës së borxhit 130,323 mijë lekë, pra më shumë se gjysma e vlerës së detyrimeve që kanë subjektet që ushtrojnë aktivitet, gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të sektorit të borxhit në arkëtimin e detyrimeve debitorë, në mos zbatim të Kreut XI- "Mbledhja me forcë e

detyrimet tatimor të papaguar”, neni 88-104 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181-Mospagimi i taksave dhe tatimeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4 faqe 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore të analizohet situata e krijimit të debitorëve dhe të nxirren përgjegjësitë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Sektori i Borxhit, të bëjë njoftim vlerësimet për detyrimet përkatëse për secilin debitor privat dhe, nëse pas njoftimeve zyrtare bizneset aktiv debitorë, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal për mos pagesë të detyrimeve.

Brenda muajit janar 2019

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale, për periudhën objekt auditimi nuk e ka planifikuar saktë taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, pasi nuk ka marrë parasysh në planifikim, hartimin dhe miratimin e planit të përgjithshëm vendor, planin e detajuar vendor për ndërtimet e reja dhe kërkesat për leje ndërtimi nga subjekte dhe individë.

Gjithashtu Drejtoria e mësipërme, nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Janë planifikuar të ardhura nga kjo taksë por realizimi i arkëtimit të saj është i ulët, pasi ka diferencë të dukshme midis planifikimit dhe realizimit në vlerën 159,131 mijë lekë, e cila ka ndikuar ndjeshëm në mos realizimin e të ardhurave dhe kryerjen e investimeve. Sa më sipërm është në papajtueshmëri edhe me pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen dhe pika 1, neni 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore të analizohet situata dhe të nxirren përgjegjësitë lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe për objektet pa leje të legalizuara. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Operacionale, në hartimit e projekt planit të të ardhurave që dërgohet për miratim në Këshillin Bashkiak, të planifikojë saktë treguesit e planit, për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe taksën e ndikimit në infrastrukturë për objektet që legalizohen. Për këtë qëllim të merret në konsideratë hartimi dhe miratimi i Planit të Përgjithshëm Vendor, Planit të Detajuar Vendor për ndërtimet e reja, si dhe të bashkëpunohet me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t dhe ZVRPP Elbasan për numrin e ndërtimeve pa leje të legalizuara.

Në planifikimin e të ardhurave për vitin 2019

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi Akt-Marrëveshjes nr.3401, datë 23.12.2011, hartuar midis Bashkisë Elbasan dhe UK Elbasan, për taksën e ndërtesës të taksapaguesve të kategorisë familjare, konstatohet parregullsi, pasi ky detyrim nuk është llogaritur sipas sipërfaqes në m², por është konsideruar si tarifë sipas numrit të banesave. Gjithashtu nuk është pasur parasysh se për personat të cilët kanë në pronësi më shumë se një banesë, niveli i taksës së ndërtesave të banimit është dyfishi i nivelit të taksës për kategorinë e cila ka vetëm një banesë. Sa më sipërm edhe pse është miratuar me VKB, është në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” neni 22. (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandim: Nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, të merren masa për të krijuar një bazë të dhënash për banesat, ku të evidentohen familjet të cilët zotërojnë më shumë se një ndërtesë banimi dhe sipërfaqet që ato disponojnë. Detyrimet përkatëse të llogariten sipas dispozitave të nenit 20 dhe 22, të ligjit nr.

9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për këtë të shfrytëzohen të dhënat nga ZVRPP, ALUIZNI, UK Elbasan.

Brenda muajit mars 2019

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” për vitin 2017 paraqitet në vlerën 66,545,449 lekë, vlerë e cila përfaqëson projektet për investime në vite. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se vlera prej 27,781,915 lekë, i përkasin e projekteve, investimet e të cilave kanë përfunduar në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga 12 ish Komunat të cilat tashmë janë pjesë e Bashkisë Elbasan, ndërsa vlera prej 38,763,534 lekë i përket projekteve për objekte të përfunduara për Bashkisë Elbasan. Vlera e këtyre projekteve, nuk është sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit. Për sa më sipër kjo llogari e pasqyrave financiare, nuk pasqyron me vërtetësi gjendjen e aktiveve, në kundërshtim me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisve që varen prej tyre, si dhe të njësisve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” i ndryshuar; rubrika 3- Procedurat e rakordimit dhe të mbylljes së llogarive; kërkesat e nenin 7, 9, 10 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (*Më hollësisht trajtuar në pikën A.2, faqe 13-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore të analizohet situata lidhur me keq kontabilizimin e mësipërm dhe të nxirren përgjegjësitë. Drejtoria e financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e projekte”, në mënyrë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, investimet e të cilave nuk kanë përfunduar, duke e transferuar në debi të llogarive të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për objektet e përfunduara, vlerën 66,545,449 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në hartimin e buxhetit vjetor në zërin e shpenzimeve, nuk janë planifikuar detyrimet e prapambetura, në këtë zë ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit. Në total treguesit e buxhetit për këtë zë për vitin 2016, 2017 dhe 2018 janë realizuar respektivisht në masën 82,7% , 81,7% dhe 82,1%. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. Planifikimi i zërit të shpenzimeve është bërë pa llogaritur detyrimet për faturat e pa likuiduara. Gjendja e faturave të pa likuiduara ndaj të tretëve më 30.09.2018 është në vlerën **176,106,951** lekë, e cila përfshin detyrime të ish komunave në vlerën 36,064,461 lekë, detyrime të Bashkisë Elbasan përpara reformës administrativo-teritoriale në vlerën 37,095,781 leke dhe detyrime të reja të krijuara pas kësaj reforme, në vlerën 102,946,709 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 52, -Kryerja e shpenzimeve të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (*Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 20-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore të analizohet situata lidhur me planifikimin, realizimin e buxhetit dhe krijimin e faturave të pa likuiduara dhe të nxirren përgjegjësitë. Nga Drejtoria e Buxhetit të marren masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave. Të merren në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave në vitin e mëparshëm buxhetor. Në vazhdimësi çdo faturë shpenzimesh të likuidohet brenda afateve ligjore (30 ditë), duke shmangur transferimin e detyrimeve nga njëri vit buxhetor në tjetrin.

7.2.Rekomandim: Titullari dhe Drejtoria e Financës të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale **176,106,951lekë**. Për këtë, bazuar në UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe Udhëzimin Plotësues nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91-Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave. Në zbatim të pikës 88 të udhëzimit të mësipërm të bëjë publikimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura në faqen zyrtare të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njesisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,379,607 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve sipas kontratës pa nr. prot., datë 09.06.2016, me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga “Sule Misiri dhe “Fehmi Kotherja”, me vlerë të kontratës 71,496,914 lekë me TVSH, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, por të paguara në vlerën **1,825,587 lekë pa TVSH, dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit dhe njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe BOE “M.” SHPK & “V. I.” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4, faqe 43-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,825,587 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomik “M.” SHPK, dhe “V. I.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot datë 09.06.2016.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit, sipas kontratës nr. prot. 9175, datë 11.05.2017, vlerë 16,151,979 lekë me TVSH, me objekt “Sistemim dhe asfaltim i rrugës “Abdyl Daiu” Lagjia 5-Maj”, lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan dhe Operatorit Ekonomik “E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë **dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **554,020 lekë pa TVSH**.

Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me nenin 8, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, me Udhëzimin e KM Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 si dhe me kontratën e mësipërme (*Më hollësisht trajtuar në pikën C.1.4, faqe 43-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Elbasan, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **554,020 lekë pa TVSH, dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt, nga Operatori Ekonomikë “E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit sipas kontratës datë 21.12.2017.

C.1 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Elbasan ka administruar 22 vendime gjyqësore të formës së prerë (vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit, detyrime pagese) në vlerën 21,293,646 lekë, nga të cilat, njëmbëdhjetë raste për “detyrim kontrate” fatura të pa likuiduara në vlerën 7,082,378 lekë, dy raste fatura të pa likuiduara nga ish Komunat, në vlerën 2,787,784 lekë, katër raste për largime të pa drejta nga puna në vlerën 1,949,708 lekë, katër raste për shpronësim në vlerën 1,080,261 lekë, një rast për vendosje gjobe të padrejtë në vlerën 89,740 lekë. Nga shuma e mësipërme për periudhën 2016-2018 është likuiduar vlera **12,989,871 lekë, efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore**, mbetur për likuidim të mëtejshëm në buxhetin e vitit 2019 vlera 8,303,775 lekë. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr.2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 20-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Titullar i institucionit të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore në vlerën **21,293,646 lekë**, të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë për efektin negativ që këto vendime i kanë shkaktuar buxhetit të njësisë vendore. Sektori juridik në rastet e proceseve gjyqësore të ndjek këtë proces në të gjitha shkallët e gjyqimit. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari të nxirren përgjegjësitë administrative dhe akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Bazuar në informacionin e dhenë nga drejtoria e financës, konstatohet se nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), për periudhën 2015-2018, në faturat e energjisë elektrike të ndriçimit rrugor të Bashkisë Elbasan, përveç vlerës së energjisë elektrike të konsumuar sipas aparatit matës, për çdo muaj është llogaritur edhe vlera e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv për 110 kontrata, ndërkohë që ndriçimi rrugor i qytetit nuk ka të instaluar aparat televiziv. Veprimet e mësipërme kanë sjellë si pasojë efekt negativ në buxhetin e njësisë vendore në vlerën **356,300 lekë** dhe janë në kundërshtim me pikën 8, shkronja “b” të udhëzimit nr. 29, datë 18.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv”, ku përcaktohet se ndriçim publik i rrugëve nuk është subjekt i pagesës së tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv, (*Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 20-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandim: Bashkisë Elbasan të hartojnë akt-marrëveshje me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), në të cilën të kërkojë heqjen e detyrimeve në vlerën **356,300 lekë** për tarifën e shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv në faturat e ndriçimit publik rrugor, të cilat janë të faturuara pas hyrjes në fuqi të udhëzimit nr. 29, datë 18.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv”. Gjithashtu t’i kërkohej OSHEE që në vazhdim të ndërpresë llogaritjen e tarifës së mësipërme në faturat e ndriçimit publik rrugor.

Menjëherë dhe në vijimësi

C.2. MASA PËR RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDOREDHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2016–2018, janë jashtë skemës së pagesës së taksa e ndërtesës, tarifë pastrimi, tarifë ndriçimi dhe tarifë gjelbërimi, 18000 familje të lagjeve të qytetit Elbasan, të cilët nuk janë faturuar dhe arkëtuar detyrime sipas akt-marrëveshjes për vlerën **43,200,000 lekë, të ardhura të munguara** për buxhetin e Bashkisë, për këto nuk ka regjistër të familjeve, me të dhënat sa është numri i familjeve gjithsej për sipërfaqet e banimit që ka secila familje dhe se kujt viteve i përket banesa para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk plotësohet njoftim detyrimi për familje, veprim në papajtueshmëri me pikën 7 të nenit 4, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Nga titullari i njësisë vendore të analizohet situata e mësipërme dhe të dalin përgjegjësitë. Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave e Aseteve, Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Kordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve, të marrë masa, të ngrejë grup punë me specialist të fushës për evidentimin e abonentëve familjarë, për lagjet e qytetit ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **43,200,000 lekë**.

Brenda muajit prill 2019

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Borxhit, konstatohet se në datën 30.09.2018 janë gjithsej **2363 subjekte debitorë për vlerën 130,323 mijë lekë**. Sektori i Borxhit nuk ka bërë njoftimin e subjekteve debitor, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 89, të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Nuk janë ndjekur procedurat ligjore për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor, në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, neni 88-104 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Sektori i Borxhit, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të paarkëtuara të subjekteve fizik/ juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për **2363 subjekteve me vlerë prej 130,323 mijë lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Dhe në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë së Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, miratuar

me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se në fund të periudhës datë 31.12.2017, janë gjithsej **10596 familje debitorë për vlerën e detyrimit prej 75,657,958 lekë** (për taksë toke në vlerën 46,160,528 lekë, për taksë ndërtese në vlerën 16,270,955 lekë, për taksë trualli në vlerën 1,887,551 lekë dhe tarifa shërbimi në vlerën 11,338,924 lekë *(Më hollësisht trajtuar në pikën B.1.4, faqe 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*).

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave e Aseteve, Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve të marrë masa dhe të kërkojë arkëtimin debitorëve për **10596 familje të vlerës 75,657,958 lekë**, sipas të dhënave të Gjendjes Civile, duke dërguar njoftim vlerësimet abonentëve familjarë me postë, për:

- Taksë toke në vlerën 46,160,528 lekë;
- Taksë ndërtese në vlerën 16,270,955 lekë;
- Taksë trualli në vlerën 1,887,551 lekë;
- Tarifa shërbimi në vlerën 11,338,924 lekë.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Për personat e atakuar në Raportin Përfundimtar nuk jepen masa disiplinore, për arsye se shkeljet e kryera prej tyre janë të korigjueshme dhe nuk kanë sjellë pasoja të rënda në mirëfunksionimin e aktivitetit ekonomik – financiar dhe shërbimeve ndaj komunitetit në njësinë vendore. Korigjimi i shkeljeve të konstatuara nga auditimi rrit eficientë dhe efektivitetin e njësisë vendore në mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave. Kryetari i Bashkisë të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të marrë masa disiplinore, bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

BUJAR LESKAJ

KRYETAR